



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 132, datë 19.10.2021

“PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 49, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS”, I NDRYSHUAR. ”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 23, pika 4 dhe 6, nenit 35, pika 5, shkronja “b”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pika 8, shkronja “a”, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 35, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemimin e taksave vendore”, i ndryshuar, vendimit nr.49, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”, të ndryshuar, vendimit nr.48, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak, “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”, si dhe në vijim të memos nr. 40539 prot., datë 15.10. 2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 49, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga bashkia e Tiranës“, i ndryshuar.”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 7 e aneksit nr. 2, “Zonat e administrimit të parkimit (ZAP) në qytetin e Tiranës” (Harta nr.1), ndryshon sipas hartës dhe tekstit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në pasqyrat e ZAP nr. 2, 3, 4, 8 dhe 16, të aneksit nr. 2, shtohen nënzonat e destinuara për parkim, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Pika 3 e aneksit nr. 3, “Zonat tarifore në Qytetin e Tiranës”, ndryshon sipas hartës dhe tekstit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Tirana Parking dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar

K R Y E T A R

ROMINA KUKO